

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR VITIN 2026

Nr	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Përgjigje	Tarifa
8	13.05.2026	Kerkesë për informacion	Nga monitorimet e kryera, të Institutit të Shëndetit Publik, tregojnë se në mjediset spitalore identifikohen mikroorganizma të njohur edhe në praktikën spitalore ndërkombëtare, ndër më të shpeshtët <i>Acinetobacter baumannii</i>, <i>Klebsiella pneumoniae</i>, <i>Staphylococcus aureus</i> dhe <i>Pseudomonas aeruginosa</i>. Këto gjetje shërbejnë për orientimin e masave parandaluese, forcimin e zbatimit të protokolleve të higjenës. Infeksionet spitalore janë një sfidë e njohur në të gjitha sistemet shëndetësore. Vlerësimet tregojnë se situata në Shqipëri paraqitet përgjithësisht e krahasueshme me vendet e rajonit, duke ju theksuar që aktualisht zbatohen protokollat lidhur me kontrollin e infeksioneve spitalore të miratuara nga OBSH. Ndotja bakteriale në mjediset spitalore është komplekse, e cila varet nga një sërë indikatorësh matës të cilët monitorohen në mënyrë të vazhdueshme. Ndërhyrjet komplekse, ndërhyrjet invazive, elementet me shumë përdorim, respektimi i masave të higjenës, sterilizimi, higjenizimi i masave të buta, procesi i dezinfektimit, proceset e ventilimit, respektimi i masave të kontrollit të infeksioneve spitalore në tërësi, për të mos neglizhuar duke filluar që nga higjena e duarve deri tek respektimi i të gjitha hapave të protokolleve për mos intersektimin e infeksionit në ambientet spitalore, përbëjnë kompleksitetin e ndotjes bakteriale apo mikrobike në mjediset spitalore. Bakteret që ju cilësoni sigurisht janë bakteret e hasura në rutinën e vlerësimeve të infeksionieve spitalore por nuk mund të përgjithësojnë evidentimin e tyre me çdo strukturë spitalore. Prezenca e një prej këtyre mikroorganizmave sigurisht shton përgjegjësinë e spitalit respektiv për të shtuar masat mbi zbatimin e protokolleve të kontrollit të infeksioneve spitalore. Theksojmë që duke patur ndërhyrje madhore në strukturat shëndetësore në Nivel Kombëtar dhe për më tepër në shërbimet spitalore, në të cilat ndërhyrjet janë dominante mbi të gjithë elementet e riskut që favorizojnë shfaqjen e ndotjes mikrobike në këto ambiente që nga garantimi i sigurtë i ushqimit në strukturat spitalore, në higjenizim dhe sigurim të materialeve të buta, tek sterilizimi i seteve kirurgjikale, tek përmirësimi i infrastrukturës, tek ventilimi i mjediseve dhe deri në zbatimin rigoroz të protokolleve për kontrollin e infeksioneve spitalore, tregojnë që këto mikroorganizma, gjithnjë e më shumë, janë më pak prezente në mjediset spitalore. Sa i përket mbylljes së sallave, ajo është pjesë organizative e spitalit të Traumës për efekt të rikonstruksionit.	Nuk ka

9.	21.05.2026	Kërkesë për informacion	Sipas kërkeses ISHP analizon parametrat mikrobiologjike dhe fiziko kimike mbi kapacitete e tij. Bazuar ne kompetencat dhe pergjegjesit e ISHP, mostrimi kryhet nga ekspertet e institucionit. Fatura e pagesës, pergatitet bazuar ne parametrat qe do te analizohen, cmimet do ti gjeni ne faqen zyrtare te Institutit te Shendetit Publik.	Nuk ka
----	------------	-------------------------	--	--------